

STATUT I SHOQERIS TREGETARE "A3 SHPK"

Sot më date 18.06.2021

Kreu I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i shoqerise

1.1 "A3 SHPK" është themeluar bazuar ne ligjin e Nr .9901 date 14.04.2008. "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "I ndryshuar , si dhe ne Aktin e Themelimit te Shoqerise nenshkruar nga Ortaku i Vetem.

1.2 "A3 SHPK" është themeluar dhe funksionon si shoqeri tregtare e forms "me pergjegjesi te kufizuar "(sh.p.k). Nga ketu e me poshte ne kete Statut shoqeria "A3 SHPK" do referohet shkurtimisht Shoqeria .

1.3 Shoqeria fiton personalitetin juridik si dhe te drejten per te kryer veprime dhe te marre persiper te drejatat dhe detyrimet gjate aktivitetit te saj te perditshem , qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregetar .

1.4 Shoqeria e realizon aktivitetin e saj , sipas objektit te pershkruar ne kete Statut , bazuar ne Legjislacionin Shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit

Neni 2

Ortaket e shoqerise

2.1 Shoqeria është themeluar nga ortaku i vetem Z.Mystehak Muçobega.

2.2 Z.Mystehak Muçobega, si ortak i vetem, pergjigjet per humbjet e shoqeris deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj .



Neni 3

Kohezgjatja

3.1 Shoqëria do të ushtroj aktivitetin e saj , sipas objektit , për një periudhë pa afat , e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar .

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë "A3 SHPK" është në adresën Lagjia Nr 1 , Rruga Vangjel Pandi, Godian Nr.57, kati i parë Sarandë.

Neni 5

OBJEKTI I AKTIVIVETIT

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "A3 SHPK" do të jetë:

- Ushtrimi i veprimtarisë së Agjencitit të Transferimit të Parave në emër dhe për llogari të Subjektit Financiar Jo –bankar , AK-Invest Sha.
- Zyre Këmbimi Valutor.
- Agjensi Udhetimesh
- Agjensi turistike dhe shitblerje biletash.
- Agjensi Imobilare , për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme .
- Ushtrimi i veprimtarisë si agjent të sigurimeve.

Kreu II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë tregëtare "A3 SHPK" është 2,500,000 (dy milion e pesëqindmijë) Leke.



6.2 Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuot.

6.3 Vlera nominale e nje 2,500,000 (dymilion e peseqindmije)leke.

6.4 Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre .

6.5 Kuotat jane nominale dhe nuk do te perfaqesohen nga letera me vlere .

6.6 Cdo kuote perfaqeson te drejttat e nje vote .

Neni 7

Regjistrimi i kuotave te kapitalit themeltar .

7.1 Kuotat dhe zoteruesi i tyre, dhe te dhenat e tjera qe lidhen me kuotat e kapitalit themeltare, regjistrohen ne nje regjister te posacem .

7.2 Forma dhe modalitetet e tjera te regjistrimit miratohen me vendim te Ortakut te vetem.

7.3 Ne rast te zoterimit te kuotave te shoqerise nga me shume se nje ortak forma dhe modalitetet e tjera te ketij regjistri miratohen me vendim te ortakeve qe zoterojne me shume se $\frac{3}{4}$ e kuotave .

Neni 8

Transferimi i pjeseve të kapitalit me vullnet të ortakut

8.1 Ortaku i vetem mund te transferoj lirisht tek te tretet, pjeserisht ose teresisht pjesen e kapitalit themeltar te shoqeris. 8.2 Ne raste se nje nje moment te caktuar pjesa e kapitalit themeltare te shoqeris zoterohet nga me shume se nje ortak , transferimi i ketyre pjeseve te shoqerise mund te behet lirisht , **ndersa** transferimi tek personat e trete mund te behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltare .

Neni 9

Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar me trashegimi

9.1 Pjeset e kapitalit themeltare mundet te trasferohetn lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuse ne kete Statut , nenpermjete trashgimise , si dhe midis bashkeshorteve ne rast ndarje pasurie .

9.2 Pjeset e kapitalit themeltare mundet te trasferohetn lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuse ne kete Statut , midis bashkeshorteve si dhe midis prindit dhe femijes ose e anasjelltas. \



Neni 10

Akti i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar.

10.1 Ne cdo rast transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet te vertetohet nepermjet nje akti noterial.

10.2 Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar pasqyrohet ne regjistrin e posacem te miratuar sipas nenit 8 te ketij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar ne kete regjister, nuk e ben te pavlefshem akti e transferimit.

10.3 Akti i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te depozitohet ne Regjistrin Tregetar jo me vone se nje muaj nga data e regjistrimit te ketij akti ne zyrat noteriale perkatese .

10.4 Kerkesa per depozitim e aktit te shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar mundet te behet nga shitesi ose nga bleresi , ose prej perfaqesuesve te tyre te autorizuar.

Neni 11

Zmadhimet e kapitalit me ane te kontributeve ne para

11.1 Kapitali themeltare i shoqerise mund te zmadhohet me kontribute ne para me vendim te ortakut te vetem.

11.2 Zmadhimi sipas pikes 1 te ketij neni behet me shlyerjen teresisht te vleres se shtuar prej Ortakut te vetem.

11.3 Shlyerja e fondeve mund te vertetohet nga nje zyre noteriale ose nepermjet nje konferme bannkare.

11.4 Ne raste se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit te fondeve , Ortakut te vetem I linde e drejta te terrheq fondet e depozituara .

Neni 12

Zmadhimet e kapitalit me ane te kontributeve ne natyre.

12.1 Zmadhimi I kapitalit themeltar nepermjete kontributeve ne natyre behet me vendim te Ortakut te vetem .



12.2. Vlera e kontributeve ne natyre si shtese e kapitalit themeltar percaktohet nga nje ekspert i cili emerohet bga Ortaku i vetem.

12.3. Te dhenat mbi kontributet ne natyre te shtuara si pjese e katpitalit themeltar pasqyrohen ne Statut dhe regjistrohen ne Regjistrin Tregetar .Ne raste te kundert zmadhimi konsiderohet I pa bere .

Kreu III

ORGANET DREJTUSE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE

Neni 13

Organet Drejtuse

Organet drejtuse te shoqeris "A3 SHPK " jane:

a)Ortaku i vetem

b)Administratori

Neni 14

Ortaku i vetem , kompetencat

14.1 Ortaku i vetem ka keto kompetenca:

a.Ndryshimi ne dispozitat e statutit

b.Caktimi dhe shkarkimi i administratorit

c.Caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/eksperteve kontabel si dhe likuiditorit/likuiditoreve.

d.Mratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit .

e.Miratimi i raportit vjetor.

f.Shperndarje e dividendeve.

g.Ndryshimi i kapitalit themeltar .

h. Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar tek palet e treat .

i.Likujdimi ose shendrimi I shoqerise ne nje forem tjetet .



Neni 15

Administratori

15.1. Administratori ka te drejte dhe detyrohet :


- a. Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise
- b. Te perfaqesojne shoqerin tregetare
- c. Te kujdesen per mbajtjen e sakt dhe te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
- d. Te kryej detyrat e tjera , te percaktuara ne ligj dhe ne statut .
- e. Miraton pagat mujore te gjitha kategorive ne punemarresve ne perputhje me tabelen e pagave te miratuar.

15.2 Mandati i administratorit është 5 (pesë vjete) me te drejtë rizgjedhje

15.3 Administratori i shoqerise eshte Z. Z.Mystehak Muçobega.

ORTAKU I VETEM

Mystehak Muçobega

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Mystehak Muçobega', is written over the printed name. The signature is stylized and cursive.